



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 144, Datë 24.04.2023

**MBI  
RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “AEE” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË  
E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, si dhe neneve 13 dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.04.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 998/7 prot., datë 19.04.2023, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “AEE” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 210, datë 27.09.2018”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 119, datë 04.04.2023 vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës Nr. 425, Seria T18, të shoqërisë “AEE” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 210, datë 27.09.2018, për një afat 5-vjeçar.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 05.04.2023 dhe 06.04.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 14.04.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Në zbatim të përcaktimeve të Rregullores, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin e plotësuar të aplikimit, sipas Shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin

për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur); shtojca 1/I; si dhe duhet të ketë kryer pagesën e aplikimit dhe pagesat e rregullimit në ERE.

- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria “AEE” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin si vijon:  
Neni 16, gërma “a”, “b” dhe “c”. **Plotësuar**  
Neni 16, pika 7. **Plotësuar**

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të rinovojë licencën Nr. 425, Seria T18, të shoqërisë “AEE” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 210, datë 27.09.2018, për një afat 5 vjeçar, duke filluar nga data 28.09.2023.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**